



V E N D I M

Nr. 595, datë 13.10.2021

P Ë R

**MIRATIMIN E NORMAVE TË TRAJTIMIT ME USHQIM
TË EFEKTIVËVE USHTARAKË TË FORCAVE TË ARMATOSURA
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “g”, të nenit 11, të ligjit nr.64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, studentët/kadetët e Forcave të Armatosura dhe kandidatët për ushtarë/detarë të trajtohen me racionin bazë të ushqimit, i cili përmban 4 300 kalori, dhe me strukturë ushqimore, sipas lidhjeve nr.1 dhe nr.3, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Personeli ushtarak i strukturave të Forcave të Armatosura, gjatë angazhimeve në operacione e stërvitje të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, përveç racionit bazë të ushqimit, të trajtohet me racion shtesë 500 kalori, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Personeli ushtarak i Forcave të Armatosura, gjatë angazhimeve në operacione, stërvitje të ndryshme të organizuara brenda e jashtë vendit dhe detyra të ndryshme në terren jashtë venddislokimit të përhershëm, si: angazhimeve gjatë pandemive, ruajtjen e objekteve të rëndësishme të veçantë, pjesëmarrje në emergjenca civile etj., të trajtohet me 2.5 litra ujë të pijshëm të paketuar për person në ditë.
4. Ministri i Mbrojtjes përcakton dhe miraton:

- a) strukturat e Forcave të Armatosura që do të trajtohen me shtesë racioni ushqimor, me 500 kalori për ditë;
 - b) strukturën e racionit bazë të ushqimit ditor (proteina, yndyra, karbohidrate), në përputhje me kaloritë dhe vlerën financiare;
 - c) normën e zëvendësimit të artikujve ushqimorë, në përputhje me kaloritë dhe strukturën ushqimore;
 - ç) trajtimin me ushqim të gatuar, pa pagesë, për ushtarakët aktivë, në rast të qëndrimit në repart mbi 8 (tetë) orë, për arsye gatishmërie, shërbimi 24-orësh apo trajnime dhe stërvitje në terren, në operacione të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit. Në këto raste ushtarakët nuk përfitojnë kompensim të ushqimit në vlerë në lekë;
 - d) njësitë dhe repartet që plotësojnë infrastrukturën e nevojshme për shërbimin e ushqimit me kontraktorë;
 - dh) normat e materialeve dhe të pajisjeve për gatim, ruajtje dhe shpërndarje të shërbimit të ushqimit në Forcat e Armatosura.
5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.
 6. Vendimi nr.88, datë 28.1.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të efektivave ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.
 7. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ARBEN AHMETAJ

MINISTRI I MBROJTJES

NIKO PELESHI

Tabela e racionit bazë të ushqimit ditor në vlerë kalorike:

Nr.	Artikujt ushqimorë	Njësia matëse	Sasia me tri vakte	K/Kalori me tri vakte
1.	Bukë gruri masive	gr	600	1603
2.	Oriz	gr	60	218
3.	Makarona	gr	50	184
4.	Fasule	gr	60	186
5.	Mish i freskët viçi	gr	200	320
6.	Vaj për gatim	ml	30	270
7.	Vaj për sallatë	ml	10	90
8.	Gjalpë	gr	30	235
9.	Sheqer	gr	50	196
10.	Sallam ose proshutë	gr	50	231
11.	Djathë i bardhë	gr	40	123
12.	Qumësht i freskët	ml	300	183
13.	Vezë	kokrra	1	79
14.	Perime për gatim	gr	350	130
15.	Perime për sallatë	gr	150	60
16.	Fruta të freskëta	gr	250	125
17.	Reçel	gr	30	67
18.	Salcë	gr	3	0
19.	Çaj mali	gr	1	0
20.	Kripë	gr	10	0
21.	Erëza	gr	1	0
Shuma				4300

Tabela e artikujve ushqimorë për shtesën 500 kalori:

Nr.	Artikulli	Njësia matëse	Sasia	K/Kaloritë
1.	Biskota	gr	50	250
2.	Çokollata	gr	25	104
3.	Vezë	kokrra	1	79
4.	Mish viçi i freskët	gr	42	67
Shuma				500

Tabela e strukturës ushqimore në vlerë kalorike për vaktin e drekës:

Nr.	Artikujt ushqimorë	Njësia matëse	Sasia me një vakt	K/Kalori me një vakt
1.	Bukë gruri masive	gr	200	534
2.	Oriz	gr	50	183
3.	Makarona	gr	50	183
4.	Fasule	gr	0	0
5.	Mish i freskët viçi	gr	120	192
6.	Vaj për gatim	ml	15	135
7.	Vaj për sallatë	ml	10	90
8.	Gjalpë	gr	10	75,8
9.	Sheqer	gr	0	0
10.	Sallam ose proshutë	gr	0	0
11.	Djathë i bardhë	gr	0	0
12.	Qumësht i freskët	ml	0	0
13.	Vezë	kokrra	0,5	39
14.	Perime për gatim	gr	200	114
15.	Perime për sallatë	gr	150	85
16.	Fruta të freskëta	gr	200	108
17.	Reçel	gr	0	0
18.	Salcë	gr	2	0
19.	Çaj mali	gr	0	0
20.	Kripë	gr	5	0
21.	Erëza	gr	1	0
Shuma				1738,8

NR.PROT. 4727/1
DATË 16.10. 2021

MINISTRISË SË MBROJTJES
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

